



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

### DRAFT

## METODOLOGJIA E LLOGARITJES SË TARIFAVE TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

### Neni 1

#### Baza Ligjore

Kjo metodologji hartohet në zbatim të neneve 7, 19, 20, 21, 22, 35, 45, 46, 53, 54, 56, 60, 62, 65, 66 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, VKM Nr. 519, datë 13.07.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, nenet 21 dhe 22 të "Rregullores për Organizimin, Funkionimin dhe Proçedurat e ERE-s" miratur me Vendimin Nr.96, datë 17.06.2016, Rregullave të tregut (përkohshme), Kodit të Matjes, Kodit të Transmetimit si dhe akte të tjera nënligjore të miratuara nga ERE.

### Neni 2

#### Qëllimi

Qëllimi i kësaj metodologjie është përcaktimi parimeve, kushteve dhe proçedurave të tarifave të përdorimit të rrjetit të transmetimit mbi bazën e parimeve të llogaritjes së këtyre tarifave duke vlerësuar të dhënat e domosdoshme për një tarifë të drejtë.

### Neni 3

#### Objektivi

Kjo metodologji ka për objektivi përcaktimin e tarifave të përdorimit të sistemit të transmetimit në zbatim të Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

## **Neni 4**

### **Përkufizime**

Termat e përdorura në këtë metodologji kanë të njëjtin kuptim si ai i përshkruar në nenin 3 e në vazhdim të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, si dhe çdo akt tjetër nënligjor të miratuar nga ERE. Termat e tjera të përdorura në këtë metodologji kanë kuptimin e mëposhtëm:

1. **Faktori i axhustimit vjetor** – një përqindje e barabarte me faktorin e inflacionit minus faktorin e përmirësimit të efikasitetit.
2. **Tarifa mesatare e transmetimit** – e ardhura mesatare për kWh e reflektuar në faturat e përdoruesve të sistemit të transmetimit për një periudhë 12 mujore, e llogaritur si e ardhura totale nga pagesat që lidhen me kapacitetin, pagesat që lidhen me energjinë dhe pagesat mujore fikse, pjesuar me kWh total të livruara nga sistemi i transmetimit në kompanitë e shpërndarjes dhe përdoruesit e tjerë të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike që ndodhen në Shqipëri.
3. **Tarifa mesatare tavan e transmetimit** – niveli maksimal i lejueshëm i tarifës mesatare të transmetimit për një periudhë specifike 12 mujore.
4. **Tarifa bazë** – vlera e tarifës së shërbimit të transmetimit e përcaktuar në përputhje me kostot në vitin bazë.
5. **Viti bazë** – viti i parë i periudhës rregullatore
6. **Viti i testimit** - një periudhë 12 mujore përpara periudhës rregullatore, e cila përdoret si bazë e përcaktimit të të ardhurave të kërkuara për vitin bazë për operatorin e sistemit të transmetimit.
7. **Tarifat e diferencuara** – tarifat për shërbimet e përdoruesve të rrjetit të transmetimit që përfshijnë pagesat që lidhen me kapacitetin, pagesat që lidhen me energjinë, pagesat mujore fikse dhe pagesat për energjinë reaktive të lidhura në nivelet respektive të tensionit.
8. **Faktori i përmirësimit të efikasitetit (faktori X)** – përqindja vjetore e reduktimit në koston e shërbimit të transmetimit që rezulton nga përmirësimet në efikasitetin e prodhimit dhe përmirësimet në teknologji.

9. **Baza e Rregulluar e Aseteve (RAB)** – vlera e asetëve fikse në pronësi të OST-së që përdoren për të siguruar shërbim për klientet e transmetimit dhe për të plotësuar detyrimin e OST-së për të siguruar qëndrueshmërinë dhe sigurinë e sistemit elektrik. Baza e rregulluar e asetëve nuk përfshin investimet financiare, letrat me vlerë, llogaritë për t'u marrë ose paratë cash.
10. **Periudha rregullatore** – Periudha për të cilën tarifat e reja hyjnë në fuqi dhe rregullohen sipas vendimit të marrë nga Enti Rregullator i Energjisë, pas një shqyrtimi të plotë dhe të detajuar të aplikimit të tarifave të paraqitura nga operatori i sistemit të transmetimit.
11. **Sistemi i shpërndarjes** – Sistemi i Shpërndarjes është sistemi i linjave, strukturave mbështetëse, pajisjeve transformuese dhe kyçëse/shkyçëse, të përdorura për shpërndarjen e energjisë elektrike dhe livrimin e saj te klientët, pa përfshirë furnizimin.
12. **Konsumi i energjisë elektrike për qëllime teknologjike** – konsumi i forcës reaktore, konsumi i kompensatorit sinkronizues, konsumi i baterisë së kondensimit dhe energjia që konsumohet nga OST-ja për përdorimin e vet dhe që merret direkt nga nenstacionet e transformimit dhe facilitetet në pronësi të sistemit të transmetimit. Humbjet në rrjet përjashtohen. Energjia e konsumuar nga stacionet gjeneruese përjashtohet.
13. **Matësi i energjisë elektrike** – një mekanizëm për matjen e fluksit të energjisë aktive dhe reaktive dhe energjisë brenda rrjetit të transmetimit ose matja e fluksit të energjisë elektrike aktive dhe reaktive dhe energjisë përmes kufijve ndërkombëtarë ose matja e energjisë elektrike aktive dhe energjisë elektrike të livruar tek klientët e sistemit të transmetimit.
14. **Klienti** - është një klient shumicë ose fundor i energjisë elektrike
15. **Klientë fundorë** - është një klient që blen energji elektrike vetëm për përdorim vetjak
16. **Enti Rregullator i Energjisë** – është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin Nr. 43/2015 dhe ligjin Nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror".
17. **Kodi i transmetimit** – Kodi i Sistemit të Transmetimit është tërësia e rregullave teknike, të cilat rregullojnë operimin e sistemit të transmetimit, si dhe përcaktojnë kushtet e shërbimit që ofrohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ndaj përdoruesve të sistemit të transmetimit, në përputhje me rregullat e ENTSO-e.

18. **Humbjet në rrjet** – Diferenca mes sasisë së energjisë elektrike të livruar në rrjetin e energjisë elektrike dhe sasisë së energjisë elektrike të tërhequr nga rrjeti i energjisë elektrike gjatë periudhës kohore respektive.
19. **Sistemi i transmetimit** – Sistemi i Transmetimit të Energjise Elektrike është sistemi i përdorur për transmetimin e energjisë elektrike në tension të lartë dhe shumë të lartë, i lidhur në paralel me sistemet e vendeve të tjera, që përfshin midis të tjerave linjat, strukturat mbështetëse, pajisjet transformuese dhe kyçëse/shkyçëse për lëvrimin e energjisë elektrike te klientët ose në rrjetin e shpërndarjes, pa përfshirë furnizimin.
20. **Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)** – ose “OST” është personi juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike.
21. **“Përdoruesit e sistemit”** janë personat fizikë ose juridikë, të cilët i furnizon ose furnizohen me energji elektrike nëpërmjet sistemit të transmetimit ose të shpërndarjes.

## **Neni 5**

### **Rregullat e përgjithshme dhe parimet bazë**

1. Kjo metodologji është hartuar në zbatim të Ligjit Nr 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, si dhe të akteve të tjera ligjore që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
2. Gjithë burimet e të ardhurave të OST-së të përcaktuara në këtë metodologji tarifash paguhen nga përdoruesit e sistemit të transmetimit.
3. Pagesat e lidhjes me sistemin e transmetimit për përdoruesit e sistemit të transmetimit nuk janë objekt i kësaj metodologjie. Pagesat e lidhjes do të caktohen në bazë të rregullores së lidhjeve të reja e cila përmban edhe metodologjinë e llogaritjes së kostove të tyre dhe janë jashtë objektit të kësaj metodologjie tarifash. Asetet e financuara nëpërmjet pagesave të lidhjes nuk përfshihen në asetet bazë të rregulluar të OST-së dhe amortizimi i këtyre aseteve fikse mund të mos mbulohet nga tarifa e transmetimit.
4. Tarifa e transmetimit duhet të shlyejë koston e aktiviteteve të mëposhtme:

- a) Pronesinë, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e linjave, kablllove, nënstacioneve të transformatorëve, qendrave dispecer dhe ndërtesave që lidhen me to si dhe facilitetet e komunikimit
  - b) Kosto e shërbimeve ndihmëse të OST-së, përfshirë pagesat e bëra OST-ve fqinje për të siguruar energji elektrike emergjente dhe rezerva të çastit dhe pagesat (nëse ka) për frekuencën dhe rregullimin e tensionit.
  - c) Kostot e kompensimit të energjisë reaktive, që mund të alokohen në një pagesë për energjinë reaktive
  - d) Kosto të tjera operimi që i përkasin Operimit të Tregut deri në ndarjen ligjore të OT nga OST e më pas, pagesat mujore përkatëse.
5. Tarifa e transmetimit nuk duhet përdorur për të shlyer koston e importeve të energjisë elektrike ose pagesat e kapacitetit që shoqërohen me energjinë e importuar ose çdo kosto tjetër të furnizuesit dhe përdoruesit sipas marrëveshjeve dypaleshe. Tarifa e transmetimit do të mbulojë kostot e blerjes së enrgjise elektrike për mbulimin e humbjeve të energjisë elektrike në sistemin e transmetimit si dhe sigurimin e shërbimeve ndihmëse e të balancimit të prokuruar në treg.
6. Rregullimi i “price cap” aplikohet për të ardhurat mesatare të lejuara të shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike. Rregullatori aprovon tarifën mesatare të transmetimit. Nëse tarifa mesatare tavan e transmetimit e përcaktuar në bazë të të dhënave historike për një nga vitet në ciklin e vlerësimit të tarifave e tejkalon tavanin e tarifës mesatare të lejuar të transmetimit të vendosur nga ERE, OST-ja duhet të ulë tarifën mesatare të transmetimit në vitin vijues në menyrë që klientët dhe përdoruesit e sistemit të transmetimit të marrin një rimbursim të shumës së të ardhurave të tepërta të mbledhura (shuma e mbi-shlyerjes).
7. Metoda “RPI - X” përdoret për t’i dhënë OST-së nxitje për reduktimin e kostove të veta gjatë ciklit të vlerësimit të tarifave. Kohëzgjatja e ciklit të shqyrtimit të tarifave të transmetimit është tre vjet. Nëse të tarifave mesatare tavan të transmetimit për ciklin pasues të tarifës së shqyrtuar nuk janë aprovuar ende para përfundimit të periudhës tre vjecare, rregullatori mund të miratojë një vendim për zgjatjen e ciklit të shqyrtimit të tarifave deri në katër vjet.

8. Caktimi i tarifave përfshin dy aktivitete të ndërlidhura: vendosjen e tarifës mesatare tavan ekonomikisht të justifikuar për vitin bazë të ciklit të shqyrtimit të tarifave dhe vendosjen e tarifës mesatare tavan të transmetimit për vitin 2 dhe 3 të ciklit të shqyrtimit të tarifave.
9. Cikli i shqyrtimit të tarifës së shpërndarjes dhe cikli i shqyrtimit të tarifës së transmetimit duhet të fillojnë në të njëjtën ditë të vitit (për shembull, 1 Janar ose 1 Korrik).
10. Financimi afatgjatë i borxhit duhet përdorur për të financuar shpenzimet e reja kapitale për aq sa është e mundur, por nuk duhet përdorur për të mbuluar kostot e operimit.
11. Aplikimi krahas informacionit dhe dokumentacionit argumentues të nevojshëm për llogaritjen e tarifës mesatare tavan të shërbimeve të rregulluara të transmetimit duhet të përmbajë dhe një informacion të plotë mbi treguesit teknik, ekonomik dhe financiar si dhe llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve për të gjithë shoqërinë.
12. Kompania e rregulluar do të raportojë qartë dhe pa dyshime kostot e çdo shërbimi të rregulluar përfshirë vetëm asetet dhe aktivitetet që lidhen me shërbimet e rregulluara. Metoda e shpërndarjes (alokimit) së kostove do të jetë e qartë dhe e kuptueshme.
13. Tarifa duhet të reflektojë kostot aktuale të shërbimit për çdo përdorues të sistemit të transmetimit dhe duhet të japi sinjale për përdorimin eficient të rrjetit të transmetimit.
14. Kostot e përfshira në tarifë duhet të jenë transparente për palët e interesuara.
15. Tarifa duhet t'i lejojë OST-së mundësinë e një kthimi të arsyeshëm mbi bazën e rregulluar të aseteve.
16. Tarifat duhet të jenë relativisht të qëndrueshme në kohë.
17. Tarifat do t'u korrespondojnë kostove që do të krijohen nga një kompani transmetimi e mirëmenaxhuar që mundohet të bëjë investime të kujdesshme, të minimizojë humbjet në rrjet dhe të shmangë shpenzimet e kota. Kur vendoset tarifa bazë, rregullatori ka të drejtë të hetojë nivelet e kostos të raportuara nga OST-ja dhe të krahasojë kostot e saj për njësi me të OST-ve të tjera.
18. Në përgatitjen e aplikimit për tarifa OST-ja do të përpiqet të paraqesë gjithë kostot me saktësi deri në 100,000 lekë. Rregullatori nuk duhet t'i diskutojë shifrat me të vogla se 100,000 lekë përveç kur ka një mosmarreveshje mbi kompensimin ose pagesën për persona të veçantë fizike.

19. Mosperputhja me secilën pjesë të kesaj metodologjie mund të çojë në refuzim nga ana e ERE-s të aplikimit për tarifë të kompanisë së transmetimit.
20. Periudha e parë rregullatore sipas kësaj metodologjie fillon në janar 2018
21. ERE do të miratojë formatet e tabelave për aplikimet për tarifa. OST do të përdorë formatet e tabelave të miratuara nga ERE kur përgatit aplikimin për çmim për një periudhë rregullimi. Formatet e tabelave mund të modifikohen për sa kohë që informacioni është organizuar në mënyrë të ngjashme dhe detajimi i informacionit nuk është më i vogël se ai i tabelave standarte të miratuara. Tabelat do të tregojnë rezultatet e vitit të testimit, rregullimet e bëra për vitin e testimit dhe për vitin bazë, duke përfshirë, por jo vetëm, shpenzimet e kompanisë, shpenzimet kapitale dhe bazën e aseteve të rregulluara për shërbimin e rregulluar.

## **Neni 6**

### **Energjia elektrike dhe bilancet e energjisë elektrike**

1. Bilanci i energjisë elektrike të OST-së për vitin bazë do të përgatitet nëpërmjet përlllogaritjes së shumës totale të energjisë në GWh të marrë nga rrjeti i transmetimit gjatë vitit bazë. Ky total është i barabartë me energjinë e marrë nga centralët gjeneruese shqiptare që levrojnë energji në rrjetin e transmetimit plus energjinë neto të marrë nga rrjetet e transmetimit të vendeve fqinje. Energjia totale e marrë duhet të ndahet në:
  - a) energji elektrike e livruar në rrjetet shqiptare të shpërndarjes
  - b) energji elektrike e livruar tek përdoruesit e lidhur me sistemin e transmetimit
  - c) humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit
  - d) konsumi i energjisë elektrike nga OST-ja për qëllime teknologjike.
  - e) energji neto e dhënë në rrjetet e transmetimit të vendeve fqinje
2. Bilanci koinçidues i pikut të fluksit të ngarkesës së OST-së do të përgatitet duke përlllogaritur energjinë elektrike totale në MW të marrë nga rrjeti i transmetimit në orën e pikut. Ky total është i barabartë me energjinë elektrike të marrë nga centralët shqiptarë të gjenerimit që levrojnë energji në rrjetin e transmetimit plus energjinë neto elektrike të marrë nga rrjetet e transmetimit të vendeve fqinje. Energjia totale e marrë duhet ndarë në:

- a) energjia elektrike e livruar ne rrjetet shqiptare të shpërndarjes
  - b) energji elektrike e livruar tek përdoruesit e lidhur me sistemin e transmetimit
  - c) humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit
  - d) konsumi i energjise elektrike nga OST-ja për qëllime teknologjike.
  - e) energji neto e dhënë në rrjetet e transmetimit të vendeve fqinj
3. Për secilin nga dhjetë vitet e fundit, humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit duhen treguar si një përqindje e energjisë së marrë nga rrjeti i transmetimit.
4. Energjia elektrike e konsumuar nga facilitetet e OST-së me tension të ulet ose mesatar dhe të livruar nëpërmjet rrjetit të shpërndarjes duhet përfshirë në shumën totale të energjisë së livruar në rrjetin e shpërndarjes.

## **Neni 7**

### **Kërkesa për të ardhura për Vitin Bazë**

1. Shpenzimet e vitit të testimit për përcaktimin e kostove për vitin bazë do të bazohet në informacionin kontabël në përputhje me Sistemin Uniform të LLogarive të aprovuara nga ERE ose Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit. Viti i testimit do të jetë një periudhë historike 12 -mujore përfaqesuese e kostove operative të shoqërisë. ERE, gjatë shqyrtimit të aplikimit për tarifë, ka të drejtë të kryej, ose kontraktojë për të kryer, një auditim rregullator të informacionit kontabël të vitit testues të OST.
2. OST mund të propozojë ndryshime të rezultateve të shpenzimeve të vitit të testimit për përcaktimin e tarifave per vitin bazë të periudhës së ardhshme rregullatore. Çdo ndryshim i tillë duhet të jetë i njohur (një artikull i veçantë) dhe i matshëm nga ana sasiore. Fondet e planifikuara për mbulimin e kostove të ngjarjeve të pasigurta apo të pa parashikuara, nuk do të miratohen nga ERE.

ERE do të marrë në konsideratë rregullime në vitin e testimit të tilla si:

1. ndryshimi i kërkesës;
2. inflacioni;
3. ndryshime në çmimin e kontraktuar;
4. ndryshime në taksa dhe sigurime;



5. rritje e nivelit të asetëve bazë të rregulluara;
  6. kosto e kapitalit;
  7. niveli i shpenzimit të amortizimit; dhe,
  8. faktori i efikasitetit.
  9. të ardhura të tjera
3. OST duhet të paraqesë justifikime për çdo rregullim/korigjim të parashikuar të rezultateve të vitit të testimit. Rregullimet duhet të specifikohen në tabelat e paraqitura nga OST në aplikimin për tarifë, si dhe dëshmi me shkrim duke dhënë prova për arsyet dhe nivelin e çdo korigjimi/rregullimi.
4. Kerkesat për të ardhura për vitin bazë do të llogariten si vijon:

$$C = C_{\text{kapital}} + C_{\text{operuese}}$$

- 4.1. TVSH-ja nuk është përfshirë në formulën e treguar më lart sepse është llogaritur nga OST-ja për çdo faturë mujore të klientit të sistemit të transmetimit për shërbimin e transmetimit dhe është treguar si një zë i veçantë në faturën mujore.
- 4.2. Kosto kapitale është e barabartë me kthimin e kapitalit, plus amortizimin.

$$C_{\text{kapital}} = R + D$$

**C<sub>kapital</sub>** –komponenti i lidhur me kapitalin i të ardhurave të synuara për vitin bazë  
**R**- kthimi mbi bazën e rregulluar të asetëve  
**D** - amortizimi i asetëve fikse dhe amortizimi i asetëve të tjera

4.2.1. Kthimi mbi bazën e rregulluar të asetëve llogaritet me formulën:

$$R = B * WACC$$

**B**- Aseti Bazë i Rregulluar në fillim të vitit bazë të ciklit të vlerësimit të tarifave

**WACC** - norma e lejueshme e kthimit të Asetit Bazë të Rregulluar.

- 4.2.2. Vlera e asetit bazë të rregulluar duhet të jetë e barabarte me koston historike te asetëve fikse të përdorura për të siguruar shërbim transmetimi, minus amortizimin, minus një rregullim për vjetërimin ekonomik.
  - 4.2.3. Trualli dhe e drejta e kalimit të përdorura nga OST-ja vlerësohet me koston fillestare të blerjes.
  - 4.2.4. Amortizimi i kategorive të ndryshme të asetëve do të bazohet mbi jetën operuese të pritshme të këtyre asetëve. Nëse të dhënat financiare janë shtrembëruar nga përdorimi i shifrave shumë të larta për jetëgjatësinë e amortizimit, atëherë OST paraqet një studim për amortizimin e asetëve i cili duhet të tregojë jetën e asetëve për çdo kategori.
  - 4.2.5. Asnjë nga asetet e OST-së nuk duhet konsideruar si aset “stranded” (me vlera të regjistruar më të lartë se vlera e tregut).
  - 4.2.6. Vetëm investime në nivele të kujdesshme të aprovuara nga ERE mund të përfshihen në bazën e rregulluar të asetëve. OST duhet të paraqesi në ERE me shkrim programin e ndarjes së investimeve të propozuara për periudhën rregullatore në përputhje me Rregulloren e procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve.
  - 4.2.7. ERE do të rishikojë investimet e realizuara kundrejt atyre të planifikuara/miratuara çdo fundviti dhe të korrigjojë tarifatat në rast se OST dështon në zbatimin e planit të investimeve.
- 4.3. Norma e lejuar e kthimit në Asetin Bazë të Rregulluar llogaritet nga një normë e lejueshme kthimi e kapitalit në vitin bazë, një normë mesatare e përlllogaritur e interesit mbi borxhin afatgjatë gjatë vitit bazë dhe një raport borxh/kapital i vet. Të treja këto vlera duhen dhënë në vendimin për tarifatat të miratuara nga rregullatori në mënyrë që supozimet e përdorura për të llogaritur normën e lejueshme të kthimit të paraqiten qartë. Norma e lejuar e kthimit mbi Asetin Bazë të Rregulluar është

mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit para taksave, e llogaritur si vijon:

$$\text{WACC} = [\text{ES} * \text{ARoE} / (1-\text{T})] + (\text{DS} * \text{CoD})$$
$$\text{ES} + \text{DS} = 1$$

Ku:

**ES** - Objektivi për raportin e kapitalit të vet në RAB

**T** - Norma e taksës së korporatës

**ARoE** - Norma e lejuar e kthimit mbi kapitalin e vet pas takse

**DS** - Objektivi për raportin e borxhit në RAB

**CoD** - Kosto e borxhit

- 4.4. Norma e lejueshme e kthimit mbi kapitalin duhet të vendoset nga rregullatori mbi bazën e nevojës së OST-së për të marrë fluksin e parave për shpenzime kapitale dhe shërbimin e borxhit afatgjatë duke gjykuar nga pasqyra e burimeve dhe përdorimit të fondeve në vitin bazë. Gjithë fitimet duhen përdorur për të mbështetur programin e shpenzimeve kapitale të OST-së dhe për të rritur vlerën e kontabilizuar të pjesës së kapitalit.
- 4.5. Nëse OST-ja mund të demonstrojë se ka një nevojë urgjente për shpenzime kapitale specifike dhe se financimi i borxhit afatgjatë për këto asete apo fluksi i parasë nuk është i mjaftueshëm për ti shërbyer borxheve të arsyeshme/të justifikuar, ERE-ja mund të vendosë të caktojë një normë të lartë tv lejueshme të kthimit të kapitalit dhe ta mundësojë në këtë mënyrë OST-në që të gjenerojë fluksin shtesë të parave që nevojiten.
- 4.6. Norma mesatare e ponderuar e interesit mbi borxhin afatgjatë duhet përcaktuar si (a) shuma e pagesave të interesit të borxhit afatgjatë gjatë vitit bazë, pjestuar me principalin total të borxhit afatgjatë (shuma totale e marrë borxh) në fillim të vitit bazë ose (b) shuma e pagesave të interesit të borxhit afatgjatë gjatë ciklit 3 vjeçar të shqyrtimit të tarifave pjestuar me shumën e sasisë së marrë borxh në fillim të vitit

bazë, shumën e marrë borxh në fillim të vitit 2 dhe shumën e marre borxh në fillim të vitit 3. OST duhet të tregojë që normat e interesit për borxhin janë në përputhje me normat tregtare të interesit për borxhin të pranuar nga kompanitë e tjera me risk të ngjashëm krediti. Çdo borxh i përfshirë në llogaritjen e normës mesatare të interesit të borxhit, që ka një normë interesi më të lartë se niveli aktual i tregut, do të rregullohet në zbritje deri në nivelin e tregut.

4.7. Gjithë përbërësit kryesorë të sistemit të transmetimit duhet të jenë pronësi e OST-së dhe jo të meren me qera. Pagesat që shoqerohen për qera (per shembull, marja me qera e mjeteve te motorizuara) do të përfshihen në shpenzimet operuese.

5. Kostot operuese të OST-së përfshijnë:

$$\mathbf{C\ operuese = C\ matjes + C\ mirembajtje + C\ paga + C\ humbjet + C\ shërb. ndihmëse + C\ shërb. të trete + C\ takse}$$

**C matjes** - kosto e matjes së energjisë elektrike dhe energjisë së livruar tek klientet e sistemit të transmetimit dhe kosto e faturimit dhe likuidimeve të llogarive me perdoruesit e sistemit të transmetimit: Kjo kategori mat kostot që lidhen me klientet dhe nuk përfshin koston e matjes së humbjeve të energjisë elektrike, konsumin e energjisë elektrike për qellime teknologjike dhe eksportin, importin dhe fluksin e tranzitit. Qëllimi i matjes së **C matese** është llogaritja e pageses mujore fikse për çdo klient të sistemit të transmetimit të bazuar në numrin e pikave ku klienti është i lidhur me sistemin e transmetimit.

**C mirëmbajtje** - pjesë zevendësimi, furnizime, mjete, lëndë djegëse dhe kosto të tjera mirëmbajtje;

**C paga** - pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe kostot (të ndryshme nga taksat) të lidhura me programet në përfitim të të punësuarve;

**C humbjet** - kostot për mbulimin dhe prokurimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit

Në llogaritjen e tarifës së transmetimit, kosto për humbjet do të llogaritet bazuar në çmimet e tregut:

**C humbje = E humbje \* P h**

**E humbje** - humbjet e energjisë në rrjetin e transmetimit gjatë vitit bazë

**Ph**- çmimi mesatar i energjisë elektrike që do të blihet në treg për mbulimin e humbjeve gjatë vitit baze.

**C sherb. Ndhimese** - një pagesë për blerjen e shërbimeve ndihmëse të nevojshme për funksionimin e sistemit.

OST duhet të paraqesi një vlerësim në lidhje me shpenzimet për shërbimet ndihmëse gjate vitit bazë. Ky vlerësim duhet të përmbajë argumenta në lidhje me parashikimin e nevojave për shërbime ndihmëse dhe çmimet përkatëse (në zbatim të Nenit 62 të Ligjit 43/2015)

**C takse** – Komponenti që mundëson që rregullatori të tregojë qartë pjesën e tarifës që i atribuohet taksave dhe prandaj është përtej kontrollit të rregullatorit. Komponenti taksë i të ardhurave të synuara të OST-së për vitin bazë, nuk përfshin TVSH-në dhe tatimin mbi fitimin.

**Neni 8**

**Ndarja e kostove për kapacitet, energji dhe pagesa fikse mujore**

1. Çdo klient i sistemit të transmetimit duhet të paguajë një pagesë kapaciteti në lekë/kW/Muaj, të bazuar në ngarkesën pik të klientit gjatë periudhes 12 mujore që mbaron në muajin e faturimit. Nëse klienti ka nënshkruar një marrëveshje me OST-në ku klienti duhet të paguajë për një shumë specifike të kapacitetit të garantuar nga marrëveshja, atëhere aplikohet pagesa e kapacitetit për atë që është më e lartë – kapaciteti kontraktual i garantuar, ose ngarkesa pik e klientit gjatë periudhës 12 mujore që mbaron me muajin e faturimit.
2. Çdo klient i sistemit të transmetimit duhet të paguajë një pagesë për energjinë në lekë/kWh, bazuar në sasinë e kWh të livruar nga sistemi i transmetimit tek klienti i sistemit të transmetimit gjatë atij muaji.
3. Çdo klient i sistemit të transmetimit duhet të paguajë një pagesë mujore fikse që synon të mbulojë matjen, faturimin dhe kostot e likuidimit të OST-së për të siguruar shërbim për atë klient gjatë vitit bazë.

4. Në aplikimin për tarifa OST-ja duhet të sigurojë një parashikim të:

- a) kapacitetit total në kW që do të tregohet në faturën e klientit të sistemit të transmetimit në çdo muaj të vitit bazë dhe shumën e ketyre totaleve mujore
- b) energjinë totale në kWh që do tregohet në faturat e klientit të sistemit të transmetimit në çdo muaj të vitit bazë dhe shumën e këtyre totaleve mujore
- c) numrin e pikave të livrimit tek klientët e sistemit të transmetimit në fillim të vitit bazë dhe numrin e pikave të livrimit në fund të vitit bazë dhe mesataren e këtyre dy shifrave

5. Të ardhurat totale të mbledhura nëpërmjet pagesave të kapacitetit në vitin bazë janë të barabarta me:

$$C_{\text{kapacitet}} = C_{\text{kapital}}$$

6. Pagesa e kapacitetit në lekë për kWh në muaj është e barabartë me:

$$P_{\text{kapacitet}} = C_{\text{kapacitet}} / L$$

**L** - shuma e kapacitetit total mujor e treguar në faturat e klientit të sistemit të transmetimit, gjatë 12 muajve të vitit bazë

7. Të ardhurat totale të mbledhura nëpërmjet pagesave të energjisë në vitin bazë janë të barabarta me:

$$C_{\text{energji}} = C_{\text{operuese}} - C_{\text{matjes}}$$

8. Pagesa e energjisë në lekë për kWh është e barabarte me:

$$P_{\text{energji}} = C_{\text{energji}} / E$$

**E** - energjia totale në kWh që do të tregohet në faturat e klientit të sistemit të transmetimit gjatë vitit bazë

9. Të ardhurat totale që do të mblidhen nëpërmjet pagesave fikse mujore në vitin bazë janë të barabarta me **C<sub>matjes</sub>**

10. Pagesa mujore fikse në lekë për pikë livrimi është e barabartë me:

$$P_{\text{mujore}} = C_{\text{matjes}} / N$$

**N** - mesatarja e numrit të pikave të livrimit tek klientët e sistemit të transmetimit në fillim të vitit bazë dhe të pikave të livrimit në fund të vitit bazë.

### Neni 9

#### Llogaritja e tarifës mesatare të transmetimit

1. Në çdo vit të ciklit të shqyrtimit të tarifës, tarifa mesatare e transmetimit është e barabartë me:

$$P_{\text{mesatare}} = (C_{\text{kapacitetit}} + C_{\text{operuese}}) / E$$

**P mesatare** - tarifa mesatare e transmetimit

2. Tarifa mesatare e transmetimit reflekton koston e pronësisë, ndërtimit, operimit dhe mirëmbajtjes së linjave, kabllove, nënstacioneve të transformatoreve, qendrave dispeçer dhe ndërtesave që lidhen me to dhe facilitetet e komunikimit. Kjo tarife nuk do të reflektojë kostot e aktiviteteve të renditura në gërmën “c” dhe “d” në pikën 4 të nenit 5, si dhe çdo kosto tjetër që nuk lidhet me aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike, sepse ato kosto duhen shlyer nga OST-ja nëpërmjet pagesave shtesë. Për shembull, kostot që lidhen me pagesat e energjisë elektrike reaktive përjashtohen nga tarifa mesatare e transmetimit.
3. Tarifa mesatare e transmetimit mund të llogaritet për një periudhë 12 mujore. Te dhenat mujore mund të jenë parashikim apo historik ose kombinim i të dhenave të parashikuara për muajt e ardhshëm dhe të dhëna të vleresuara për muajt e fundit.

### Neni 10

### **Komponenti i transmetimit të tarifave të klienteve fundore**

1. Në aplikimin e tarifave OST-ja duhet të paraqesë për çdo furnizues të kompanisë së shpërndarjes, një perlllogaritje të të ardhurave totale të OST-së që duhen mbledhur nga ai furnizues gjatë vitit bazë nëpërmjet pagesave të kapacitetit, pagesave të energjisë dhe pagesave të matjes.
2. Është përgjegjësi e DSO e cila kryen shërbimin e shpërndarjes së energjisë elektrike për FSHU dhe çdo furnizuesi tjetër të licënsuar apo klient tjetër që të përgatisë një aplikim tarife në të cilën të ardhurat totale të OST-së për atë kompani shpërndarje të mblihdhen nga klientet fundorë në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuuese. Grupet e krahasueshme të klientëve fundore të lidhur me sistemin e shpërndarjes duhet të paguajnë direkt ose indirekt, të njejtat pagesa transmetimi.
3. Në metodologjinë e tarifave të klienteve fundore dhe në metodologjinë e tarifave të përdorimit të rrjetit të sistemit shpërndarës, pagesat e kapacitetit për përdoruesit e sistemit të shpërndarjes që OSSH i paguan OST-së duhen ndarë mes grupeve të klientëve të lidhur me sistemin e shpërndarjes, sipas kontributit të çdo grupi në ngarkesën koinçiduese pik të kompanisë shpërndarëse. Kjo llogaritje duhet të marrë në konsideratë humbjet teknike në nivele të ndryshme tensioni si dhe faktorin e ngarkesës vjetore dhe ngarkesën vjetore pik në kW të çdo grupi klientësh.
4. Nëse aplikohet pagesa e energjisë së OST-së për konsumin e energjisë elektrike në kWh të treguar në faturat e klienteve me tension të mesëm dhe të ulet, të ardhurat totale do të jenë më pak se shuma e pagesave të energjisë elektrike të paguara nga kompania e shpërndarjes OST-së, që përfshin pagesat e energjisë të shoqëruara me humbjet në rrjetin e shpërndarjes. Nëse pagesa e kapacitetit të OST-së aplikohet për ngarkesën pik në kW të treguar në faturat e klientëve ose të vlerësuara për grupet e klientëve, të ardhurat totale ka të ngjarë të jenë më të mëdha se sa shuma e pagesave të kapacitetit të paguara nga kompania e shpërndarjes OST-së, sepse do të ketë një farë diversiteti mes ngarkesave pik. Prandaj, mund të përfshihet pagesa e energjisë së OST-së dhe pagesa e kapacitetit të



OST-së në tarifën e klientëve fundore dhe të arkëtohet shuma “korrekte” e të ardhurave. Kjo është një mënyrë shumë e thjeshtë për të vendosur komponentin e transmetimit të tarifave të klienteve fundorë, dhe do të ishte e pranueshme për ERE-n me kusht që kompania e shpërndarjes të shlyejë as më shumë dhe as më pak se koston e vet totale të shërbimit të transmetimit nëpërmjet këtyre komponentëve të energjisë dhe kapacitetit të tarifës së saj.

5. OST-ja duhet të shqyrtojë aplikimet për tarifa të paraqitura nga furnizuesit e kompanisë së shpërndarjes, për të siguruar se të ardhurat totale të OST-së për atëkompani shpërndarje janë arkëtuar nga klientët e kompanisë së shpërndarjes në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese. OST-ja duhet të informojë ERE-n nëse kostot e sistemit të transmetimit i janë ngarkuar klientëve fundore në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese. Opinioni i OST-së do të merret në konsideratë nga ERE në shqyrtimin e tarifave të propozuara për klientët tariforë.

## **Neni 11**

### **Vendosja e tarifave mesatare tavan të transmetimit**

1. Për vitin bazë, tarifa mesatare e transmetimit është e barabartë me tarifën mesatare të transmetimit të llogaritur sipas koston në vitin bazë.
2. Për vitin e dytë të ciklit të vlerësimit të tarifave (Viti 2), tarifa mesatare e transmetimit për vitin bazë shumëzohet me faktorin vjetor të rregullimit:

$$A = (1 + RPI - X)$$

A- faktori i axhustimit vjetor

**RPI**- norma e inflacionit për çmimet e konsumit e parashikuar për Vitin e 2-të nga Banka e Shqipërisë ose INSTAT

**X-** faktori i përmirësimit të efijencës

3. Vlera e X-it duhet përcaktuar në bazë të studimit të standarteve të operatoreve të sistemit të transmetimit, në përputhje me "Rregullat e cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit". Në mungesë të këtyre rregullave, faktori X do të konsiderohet zero.
4. Nëse aktiviteti aktual financiar i OST-së në çdo vit të ciklit të vlerësimit të tarifave është më i mirë nga sa tregojnë parashikimet financiare të aplikimit të tarifave ose më mirë nga miratimi i ERE-s, mund të jepen bonuse për shoqërinë pa ngritur tarifën mesatare të transmetimit mbi tarifën mesatare tavan të transmetimit.
5. Për vitin e tretë të ciklit të shqyrtimit të tarifave (Viti 3), tarifa mesatare e transmetimit për vitin e dytë shumëzohet me faktorin vjetor të axhustimit duke përdorur vlerën RPI që i korrespondon Vitit 3.
6. Për vitin e katërt të ciklit të shqyrtimit të tarifave (Viti 4), e ardhura e transmetimit për vitin e tretë shumëzohet me faktorin vjetor të axhustimit, duke përdorur një vlerë RPI që i korrespondon Vitit 4. Nëse tarifatat e transmetimit për ciklin tjetër të korigjimit të tarifave janë miratuar para mbarimit të periudhës trevjeçare atëherë nuk do të jetë nevoja të llogaritet e ardhura mesatare e transmetimit për Vitin 4.
7. Sipas kësaj metodologjie kryhet axhustim/korigjim në tarifën mesatare tavan në vitin e ardhshëm, panvarësisht se axhustimet bëhen në periudhën rregullatore pasardhëse.
8. OST-ja nuk duhet "ndëshkuar" kurrë për mbi-kthimin e të ardhurave, nëpërmjet rregullimit të normës se lejueshme të kthimit të kapitalit ose nëpërmjet rregullimit të çmimit  $P_h$  që është caktuar për humbjet në rrjet dhe për konsumin e energjisë elektrike për qëllime teknologjike. Mbi-kthimi i të ardhurave mund të rezultojë nga gabime në parashikim dhe nga ngjarje dhe prirje të papritura në sektorin e energjisë elektrike.

9. Mbi-kthimi i të ardhurave gjatë vitit të fundit të ciklit të shqyrtimit të tarifave u duhet rimbursuar klientëve të sistemit të transmetimit nëpërmjet axhustimit në nivelin e pagesës së energjisë në vitin bazë të ciklit pasues të axhustimit të tarifave.
10. Në rast se një ngjarje e “forcës madhore” çrregullon sistemin e transmetimit, OST-ja mund t’i paraqesë në çdo kohë ERE-s një kërkesë për leje për të axhustuar pagesën e energjisë në tarifën e transmetimit në mënyrë që OST-ja të arkëtojë një shumë specifike shtesë të ardhurash. Megjithatë, rritja e tarifës së transmetimit nuk do të sigurojë të ardhura të rëndësishme për sektorin e energjisë elektrike nëse nuk rritet tarifa për klientet tariforë. OST-ja duhet të synojë të arrijë tarifa transmetimi të qëndrueshme dhe të parashikueshme.

## **Neni 12**

### **Dispozita të fundit**

Metodologjia e llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike u miratua nga Bordi i ERE -s me Vendimin Nr.180, datë 08.11.2017. Metodologjia e miratuar me Vendimin nr. 59, datë 29.12.2005 shfuqizohet.